VENDIM
Nr. 157, datë 7.10.2020

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "YLLIAD" SHPK, NR. 9, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, NR. 97, DATË 28.7.2015

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 13 dhe 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 105/2, datë 30.9.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për rinovimin e licencës së shoqërisë "YLLIAD" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 139, datë 21.8.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "YLLIAD" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "YLLIAD" sh.p.k.

- Me shkresat nr. 1013/2 prot., datë 26.8.2020, si dhe nr. 1013/5 prot., datë 22.9.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar, si dhe evidentoi nevojën për informacion shtesë.

- Me shkresën e datës 10.9.2020, protokolluar në ERE me nr. 1013/4 prot., datë 11.9.2020, si dhe me *email*-in e datës 23.9.2020, shoqëria ka përcjellë në ERE dokumentacionin e plotësuar e po ashtu, në këtë shkresë shoqëria është shprehur se pas një rishikimi të dokumentacionit të depozituar për qëllime të këtij aplikimi, ka kërkuar që të merret në konsideratë kërkesa e saj për të ndryshuar një pjesë të dokumentacionit të depozituar më herët.

- Shoqëria "YLLIAD" sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 17.4.2009, është e regjistruar pranë QKB-së si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (QKB).

- Shoqëria "YLLIAD" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit për rinovim licence dhe atë të rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë "YLLIAD" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" "c"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 9, seria T15, të shoqërisë "YLLIAD" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, data 28.7.2015, për një afat 5-vjeçar duke filluar ky afat, nga data 29.7.2020.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti